



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 22.04.2016

Ref.: 235/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 41-të, të mbajtur më 14 prill 2016, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet në nivel institucional BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale "Qeap Heimerer" për periudhën tre vjeçare 14 prill 2016 - 30 shtator 2019.
- II. Riakreditohet programi i studimit për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 - 30 shtator 2019:
  - Infermieri, BSc, 180 ECTS, maksimumi 40 student për vit akademik

**A r s y e t i m i**

BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale "Qeap Heimerer" ka parashtruar kërkesë pran Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim institucional dhe riakreditim të programit të studimit: Infermieri, BSc, (180 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 14 prill 2016 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale "Qeap Heimerer", dhe pas shqyrtimit të rekomandimeve përfundimtare të dhën nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale "Qeap Heimerer" me 22.03.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Danica Zeleznik, Prof. Dr. Helvi Kyngas, dhe Prof. Dr. Milan Pol, dhe duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC mori vendim pozitiv për akreditim.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Shkolla e Lartë Profesionale "Qeap Heimerer";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof Asoc. Dr. Berim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

